

	KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	---	---

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	02/ 2026
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	16.06.2026

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSBB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSBB).

Takimi filloi në ora 10.00

Në takim morën pjesë:

Bali Muharremaj - Kryetar i Komunës
Avni Bytyqi - koordinator i KKSBB-së
Safet Hoxha- Komandant në Stacionin Policor në Therandë
Haki Hoxha - përfaqësues i Komunitetit Islam
Albert Demaj - përfaqësues i Komunitetit Katolik
Amir Hoxha - Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
Feriz Gega - përfaqësues e EVSB-së
Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit
Habibe Bytyqi - Zyrtare për Barazi Gjinore
Vedat Shatri - përfaqësues i FSK-së
Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së
Shpëtim Selimi - Kryetar i KPAK-së
Rilind Kuçi - përfaqësues i OJQ-ve
Refki Zogaj - përfaqësues i Komunitetit të Biznesit
Eurolinda Zenelaj - përfaqësuese e Mediave lokale
Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së
Luljeta Tafolli - përfaqësuese e KPAK-së
Luljetë Berisha - përfaqësuese e Shqiptarëve
Shkëndije Shabanaj - Kryesuese e KK-së dhe përfaqësues i KA-li
Zekë Berisha - përfaqësues i KR-ja
Nazim Shabanaj - përfaqësues i KE-ja

Mbledhjen e hapi Nënkyetarja e Komunës e cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturanët;**
- 3. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm;**
- 4. Përgaditja dhe vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;**
- 5. Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese në territorin e komunës;**

Nënkyetarja - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Nënkyetarja - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturanët’;

Remzi Bajselmani - përshëndet të pranishmit. Sipas statistikave që ka DKA, këtë vit janë regjistruara 571 maturanë mirëpo ka pas lëvizje gjatë vitit dhe tani është numri më i vogël për 11 maturanë. Procesi mësimor për maturanët ka përfunduar me 14.05.2026 dhe sipas planit të punës është organizuar edhe testi i brendshëm në dy shkollat profesionale. Në bazë të planifikimit shkollat këtë vit kanë organizuar ekskurzionin e maturanëve në shtetin e Shqipërisë dhe të tri shkollat i kanë realizuar pa asnjë incident dhe procesi ka rrjedh sipas planifikimit. Gjithëashtu janë organizuar edhe mbrëmjet e maturës për tri shkollat dhe raportet tregojnë se ka rrjedh pa ndonjë pengesë. Me 20 qershor bëhet organizimi i testit të maturës ku do të nënshtrohen 560 maturanë dhe të gjithë kanë aplikuar në sistemin eksova. Jemi në përgaditjet e fundit të organizimit të qendrave të testimit dhe planifikojmë që këtë vit ti organizojmë në tri shkollat e mesme katër qendra testimi. Po ashtu gjimnazi është duke punuar këtë javë për testin e brendshëm. Nëpër shkollat janë përcjell të gjitha udhëzimet dhe broshurat për testin e maturës 2026 dhe besojmë që çdo gjë është përgaditur mirë deri më tani.

Drilon Zyba - çka është bërë me këta 11 nxënës? A kanë dal jashtë shtetit apo janë përjashtuar.

Remzi Bajselmani - nuk ka të përjashtuar por ose kanë shkuar në shkollat tjera ose kanë dale jashtë shtetit. Nuk kam informatë.

Rekomandim: DKA të vazhdon me aktivitete të tilla dhe të vazhdojë me organizimin e testit të maturës për maturanët ashtu siq e kërkon ligji dhe ministria.

Nënkyetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 3. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm;

Safet Hoxha - përshëndet të pranishmit. Vitin e kaluar, gjatë verës kemi pranuar dhjetra ankesa, sidomos në orët e vona të natës për gjashtë lokale. Kemi 1 në rrugën "Hajdin Berisha", 1 në rrugën "Brigada 123" dhe 4 i kemi në rrugën "Abdyl Rama". Aty ka banesa afër dhe ka muzikë me zë të lartë. Në vitin e kaluar kemi reaguar me dhjetra herë dhe përkundër që organizojmë takim me gjithë pronarët, planifikojmë njëjtë edhe këtë vit takim me këta pronarë që me gjet një mesazh. Do të ishte mirë që edhe komuna me fillu me përgadit edhe një rregullore për raportin akustikë. E di që e keni rregulloren për orar të punës por

tash me zhvillimin e teknologjisë këto mund të bëhen edhe në mënyrë automatike. Shembull i mirë se si funksionon e kam pa edhe në Prishtinë dhe një gjë e ngjashme mund të bëhet edhe këtu. Ne si polici funksionojmë vetëm me ligjin për rend dhe qetësi publike dhe nuk kemi ndonjë aparat që e masim sepse edhe ligji për rend dhe qetësi publike nuk e përcakton dhe kjo pjesë i takon komunës dhe besoj mund të rregullohet sepse nuk kushton shumë. Do të ishte mire që ne me gjet një modalitet edhe ata mos me i pengu por edhe qytetarët mos me pas ankesa për zhurmën e madhe. Do të ishte mire që ne bashkë me inspektorët me u koordinu bashkë dhe me vepru bashkë në këtë kohë. Deri në ora 22:00 ne nuk reagojmë kur thirrën qytetarët por pas ores 22:00.

Feriz Gega - ndoshta këtë vit ata e kanë bërë një zgjidhje, e kanë izolu lokalin.

Drilon Zyba - tema e këtyre lokaleve ka 4 vite që diskutohet. Për dy vite e gjys e kam pas kërkesën edhe zyrtare këtu për komandantin paraprak për procedurë çka keni ndjek ndaj këtyre lokaleve dhe ende nuk kam marrë përgjigje. Policia nuk ka qenë e barabartë ndaj lokaleve. Nëse është e mundur me pas një raport këtu dhe ndoshta mundemi me gjet zgjidhjen.

Safet Hoxha - të gjitha lëndët për kundërvajtje shhkojnë në gjykatë. Shkalla e dytë, komisioni për vendosje neve na ka ndalu dhe ne nuk guxojmë më me shqiptu gjobë. Ne bëjmë vetëm fletparaqitje për gjykatë për kundërvajtje. Mund ti nxjerr statistikat sa here kemi reagu dhe çka është bërë por duhet me shiku edhe me zyrën ligjore sa guxoj me shpërnda informacionin edhe për subjekte individualisht, por si shifra mund ti japim.

Avni Bytyqi - komandanti e përmendi që komuna jonë e ka rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për të gjitha subjektet afariste dhe në bazë të asaj rregullore ajo bie në kompetence dhe autoritet të policisë që ta monitorojë çështjen në teren dhe mund të shqiptojnë gjoba aty ku haset që shkelet ajo rregullor. Në kuadër të asaj rregullore është e përcaktuar edhe çështja se në cilin orar duhet të ndalet muzika.

Rekomandim 1: policia në bashkëpunim me inspeksionin të bëjnë kontrolla të vazhdueshme në qytetin e Suharekës dhe nëpër fshatra aty ku dyshohet dhe ka raste që paraqiten nga qytetarët që prishin rendin dhe qetësinë publike ose që nuk e respektojnë rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

Rekomandim 2: komuna të fillojë procedurat që të hartojë një rregullore për çështjen e matjes së akustikës.

Nënkryetarja - i hedh në votim rekomandimet.

Aprovohen rekomandimet

Pika 4. Përgaditja dhe vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;

Avni Bytyqi - komuna jonë në vazhdimësi për çdo vit bën parapërgaditjen për çështjen e vetëdijësimit të qytetarëve dhe për mbrojtjen nga zjarri gjatë sezonit të verës. Ne çdo herë e bëjmë një apel përmes faqes së komunës që mundësisht gjatë verës dhe temperaturave të larta, qytetarët mos të ndezin zjarre sepse shkaktohen zjarre të mëdhaja dhe është problem. Ne gjithëashtu çdo herë i njoftojmë edhe pishinat që nëse ka nevojë, zjarrëfikësat me u furnizu me ujë nëse ndodh një fatkeqësi e zjarrit.

Refki Zogaj - kur është fjala për këto lloj tema duhet me qenë shumë syqel, por unë e kam edhe një vërejtje që zona industriale në Shirokë duhet të mirëmbahet sepse zakonisht kompanitë e ndërgjegjshme e mirëmbajnë kositjen e të gjitha para kompanive të veta por në disa kompani ka baroja të mëdhaja dhe ato kompani nuk e kanë një përgjegjësi të tillë dhe rrezikshmëria është e madhe në Z. Industriale. Propozoj që komuna ti angazhoj inspektorët të këto kompani, ti japin vërejtjet dhe pas një jave nëse nuk e realizojnë, edhe të pasojnë denimet. Në sezonën e korrje-shirjes më herët organizoheshin edhe kompanitë apo ato që i kanë autokombanjat dhe traktorat që nëse vje të përhapja e zjarrit, ta lokalizojnë zjarrin. Unë i kam disa ankesa në Z. Industriale në Shirokë që kompanitë ankohen. Kisha apeli që kompania e cila merret me përmirësimin e infrastrukturës së asfaltit në ato vende ku e gërryen asfaltin, sidomos në Z. Industriale, të lihen dy ditë dhe të tretën ditë duhet të asfaltohet ose mos të vepron fare.

Nënkryetarja - I kemi dy kategori të dëmtimit të asfaltit. Njëra pjesë e prishjeve është ku Hidroregjioni investon në gypat e ujit ose kanalizimit dhe ata janë të obliguar me kthy gjendjen në gjendje paraprake por kjo në realitet nuk ndodh dhe fatkeqësisht kompanitë publike nuk na japin përgjegjësi por i përgjigjen direkt ministrisë dhe fuqia jonë e ndikimit dhe ndëshkimit mbi ta, nuk ekziston. Te pjesa e

dytë është kompania e cila është dhënë nga prokurimi i komunës për rregullimin e gropave, të asfaltit, etj. të cilat kanë fillu me i kry tash këto ditë. Ne nuk kemi interes me u bë këto punime kur të vijnë diaspora por jo gjithmonë është e mundur për shkak të vonësive, buxhetit, procedurave të prokurimit, etj. E kemi diskutu në bord që kompanisë duhet me i kërku të punojë natën.

Drilon Zyba - para disa mbledhjeve unë personalisht ju kam njoftu që na ka ardhë një lloj donacioni në fshat dhe si përfaqësues i KLSP-së. Unë momentalisht i kam në shtëpi sepse zyrën komuna ma ka marrë në Bukosh për qerdhe dhe është mirë. Kërkesa ime është për një zyre që të na hyjë në funksion në fshat. Aty është kryesia, KLSP-ja dhe lokacionin e kemi gjetë, është në ambulantën e shtetit. Nëse kanë nevojë zjarrëfikësat apo kushdo, jemi të hapur për bashkëpunim për paisjet që i kemi.

Avni Bytyqi - në ambulantë është pak problematike me vendos zyrën e kryesive të fshatrave dhe zyrën e KLSP-së sepse ajo ambulantë është e dedikuar për çështje të shëndetit. Nëse gjeni ndonjë lokacion jasht territorit të ambulantës, besoj që Kryetari ka me aprovu.

Drilon Zyba - është veq dhe fizikisht nuk ka të bëj me pacientat dhe është hapësirë publike.

Avni Bytyqi - kërkesën mund ta bëni dhe tani e shqyrtojmë.

Safet Hoxha - te bizneset ka pas interes me ble cisterna, me përgadit staf për zjarre. A është bërë diçka në këtë drejtim?

Refki Zogaj - jemi duke punu në atë drejtim. Aty ku e kam unë objektin janë në dispozicion 400 litra ujë. Ne kemi bashkëpunu dhe e kemi mundësu dhe sa e di ka ardhë një kamion në Suharekë prej Austrisë. Kur ka qenë drejtori Enver Shabani kemi bisedu që në objektin e Shirokës që është një kamion, të aftësohet. Ne bëjmë shumë planifikime por në momentin kur të dalim prej atij takimi dhe kur takohemi takimin tjetër fillojmë prej të njejtës pikë. Në këtë drejtim neve na nevojitet edhe përkrahja e komunës. Kemi kërku bashkëpunim dhe kemi pas premtime por relizime s'kemi pas.

Safet Hoxha - nuk ju kam premtu por ju kam thënë që mund të organizoj me trajnu stafin.

Rekomandim: të vazhdojë bashkëpunimi në mes policisë dhe komunës me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve dhe njoftimit të pishinave që në rast nevojë për t'u furnizuar me ujë.

Avni Bytyqi - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 5. Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese në territorin e komunës;

Avni Bytyqi - sa i përket mungesës së trotuareve ne veq e kemi diskutu paraprakisht dhe kemi dhe i kemi lëshu një rekomandim inspektoriatit dhe policisë që të bëj lirim e hapësirave publike, lëvizjen e lire të qytetarëve sidomos nëpër qytet dhe rrugëve nëpër periferi.

Safet Hoxha - ne jemi duke përgadit me bë ndryshime në disa shenja dhe jemi në kontakt me Drejtoinë e Urbanizmit.

Drilon Zyba - vitin e kaluar kemi diskutu si KKSBB se çka me bë me inspektoriatin por përjashtim vetëm një ditë që kanë dal në teren, më nuk janë pa. Diskutimi ka qenë se a me ja vendos disa pika kafeve apo jo dhe Drejtori i Inspektoriatit nuk na ka infomu asgjë. Problemi është tepër evident sidomos në shesh. Vija për të verbër bllokohet prej tavolinave të kafiterive.

Nënkryetarja - në mbledhjen e bordit e kemi diskutu me Drejtoinë e Inspeksionit që vija për të verbërit nuk goxon me u blloku. Drejtoria e Urbanizmit i ka caktu pikat deri ku lejohen që lokalet me i pas terasat dhe inspektimi i tyre do të bëhet në masa dhe periudha të rregullta te sheshi.

Drilon Zyba - siq tha edhe Zogaj, ne po vim po folim këtu por kurgja më tutje.

Nënkryetarja - unë personalisht jam befasu kur e kam pa që sheshi në Suharekë ka një vijë për të verbërit sepse nuk e kanë sheshet as në Prishtinë dhe as në shumë qytete të tjera dhe sa i përket inspektoriatit e kemi diskutu që ajo pjesë duhet të respektohet.

Feriz Gega - Kemi një pjesë shumë të mirë te parku që mundemi me dal dhe me shfrytëzu por pjesa lartë, shtegu i ecjes është një pjesë shumë e frekuentuar prej njerëzve por nuk ka ndriçim absolut. Ndriçimi ka qenë por tash nuk po funksionon dhe do të ishte mirë të rregullohet.

Nënkryetarja - Drejtoria e Shërbimeve Publike është në proces të lidhjes së kontratës për sanimin e ndriçimeve publike në zona të caktuara dhe gjithësesi do ta diskutoj me drejtorin këtë çështje.

Eurolinda Zenelaj - Sigurisht policia duhet ta dijë që patëm një aksident në Shirokë përball Kastratit, në zebra. A ka mundësi m'u vendos police të vdekur para atyre zebrave sepse aty është shqetësuese se si veturat ecin dhe nuk besoj që policia mundet me nejt 24/7 me radar. Edhe pse ka shenja aty, ato nuk respektohen.

Safet Hoxha - ne mundemi me pas prezencë pak më të madhe por çështja e policëve të shtrirë nuk është në kompetencën tonë.

Nënkryetarja - të gjitha rrugët që janë regjionale, që lidhen komunë me komunë, janë pjesë e ministrisë.

Eurolinda Zenelaj - a ekziston mundësia jonë me bo kërkesë në ministri.

Avni Bytyqi - zakonisht policët e shtrirë lejohen vetëm para institucioneve shkollore dhe jo ndoshta para objekteve afariste. Është shpejtësia e kufizuar.

Rilind Kuçi - në dalje të Suharekës për Rahovec, në rrugën "Skënderbeu", aty janë dy pengesa që ti i kalon para se me shku te rrethi. Pasi nuk po bënë me vendos pengesa, pse i kanë vendos aty?

Safet Hoxha - ajo është në domen të komunës. Ne aksidentet i kemi shqetësimin më të madh në nivel të Kosovës. Zona në Shirokë është përgjegjësi e policisë së trafikut por ne do të kordinohemi që policia e trafikut dhe policia e stacionit policor Suharekë me kordinu kohën kur duhet me qenë prezentë atje.

Rilind Kuçi - është edhe rruga te rrethi në Shirokë ku ndahesh në anën e djathtë për me dalë në Sopijsë. Është shqetësuese që çdo rrugë e re që është shtrur, qytetarët më shumë e përdorin si shetitje se sa si rrugë frekuentuese për vetura. Aty ose duhet të bëhen trotuare ose policia le të fillojë me dënu edhe këmbësor e jo vetëm vetura.

Safet Hoxha - ne si shofera duhet me qenë më të kujdesshëm. Nuk është ndonjë zonë shumë e qarkullueshme për veç të marteve kur është ditë tregu.

Rekomandim 1: komuna ta ketë parasysh që të gjitha rrugët që nuk kanë trotuar, të rregullon trotuaret dhe të bëj sinjalizimin e rrugëve aty ku ka nevojë, edhe sipas kërkesës së policisë.

Rekomandim 2: policia në bashkëpunim me Inspeksionin ti lirojnë trotuarët me qëllim të lëvizjes së lire të qytetarëve.

Avni Bytyqi - i hedh në votim rekomandimet.

Aprovohen rekomandimet

Takimi përfundoi: 11:00

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj